



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborui Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 368/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Muhamet Bojkaj, nga fshati Isniq, komuna e Deçanit, në cilësinë e votuesit, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja, me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Muhamet Bojkaj, nga fshati Isniq, komuna e Deçanit.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, Bekë Berisha, në Vendvotimin 0108C/01R.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatit përfundimtar.
- IV. Hyjnor Osdautaj** me nr. të letërnjoftimit [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 0108C/01R, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga Muhamet Bojkaj, nga fshati Isniq, komuna e Deçanit, në cilësinë e votuesit, i cili pretendon se në vendvotimin 0108C/01R ka votuar ai së bashku me familjen e tij, dhe nuk është e mundur se kandidatit të koalicionit PAN, Bekë Berisha, mos të numërohet asnjë votë në vendvotimin e lartcekur. Sepse unë dhe familja ime kemi votuar për të njëjtin. Me propozim për PZAP-in që ankesa të aprovohet si e bazuar.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në QNR konstatohet se kandidati me nr.106, nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, në FRK-në e krijuar në Vendvotim nuk e posedon asnjë votë, ndërsa pas hetimeve nga paneli, vërtetohet se parashtrësi i ankesës i posedon 17 vota të vlefshme në Vendvotimin 0108C/01R .

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkritazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrjen në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shklljc të dispozitës së sipërcituar sepse parashtrësit të ankesës nuk i janë regjistruar asnjë votë në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 17 vota.

Nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LPZ-së, urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 pika d, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 368/2017 më datën 02.07.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.